

MË SHUMË SE TË ARRISH.



INFO-GUIDË për refugjatënë regjistrimin fillestar shtetëror nëSaksoni-Anhalt

- Procedura e regjistrimit fillestar
- Procedura e azilit
- Ofertat për integrim



GJITHÇKA QË DUHET TË DI.

Rreth kësaj broshure

Kjo broshurë është për njerëzit që aplikojnë për azil në Saksoni-Anhalt. Ajo ofron një orientim fillestar për proceset e rëndësishme rreth qendrës së regjistrimit fillestar, procedurës së azilit dhe jetës së mundshme në Gjermani. Ajo nuk zëvendëson këshillat e hollësishme individuale.

Ju lutemi vini re: Ky botim përmban ndryshimet aktuale deri më 07/2021. Plotësia e të gjithë informacionit nuk është e garantuar. Për informacione të mëtejshme, fletushka emërton personat kompetentë të kontaktit në seksionet individuale.

Zur Orientierung in Ihrer Erstaufnahmeeinrichtung liegt dieser Broschüre ein Lageplan des Objektes bei.

Versioni online i broshurës është i disponueshëm në disa gjuhë përmes portalit të integrit Saksoni-Anhalt në linkun www.integriert-in-sachsen-anhalt.de.

Risi: Përdorni ueb-aplikacionin tonë <http://erstinfos.de>!

Botuesit dëshirojnë të falënderojnë stafin në Pikën Qendrore të Kontaktit për Azilkërkuesit në Shtetin e Saksonisë-Anhalt dhe shërbimin këshillues të procesit të azilit Caritas për mbështetjen e tyre miqësore në përgatitjen e dorëshkrimit. Dëshirojmë të falënderojmë Këshillin e Refugjatëve të Saksonisë-Anhalt për informacionin dhe komentet kritike.

Si mirëseardhje

Mirë se vini në Saksoni-Anhalt!

Ju keni arritur në Qendrën kryesore të regjistrimit fillestar të shtetit të Saksoni-Anhalt (ZAST) dhe jeni në fillim të procedurës së azilit. Saksoni-Anhalt është një shtet kozmopolit. Ne angazhohemi për t'ju pranuar si refugjatë në mënyrën më të mirë të mundshme dhe për t'ju hapur dyert e integrit në një fazë të hershme. Shumë njerëz gjithashtu angazhohen vullnetarisht për këtë ose ofrojnë mbështetje në kohën e tyre të lirë.

Për të lehtësuar orientimin në qendrën tuaj të regjistrimit fillestar dhe për t'ju mbështetur me procedurën e azilit, ne kemi bashkuar informacione të rëndësishme për këtë fazë të parë të qëndrimit tuaj në faqet në vijim (Data 01/2021).

Punonjësit tanë dhe vullnetarët punojnë shumë për të siguruar kushtet më të mira të mundshme të jetesës. Megjithatë ndodh shpesh që proceset të zgjasin më shumë sesa pritej. Në raste të tilla, përpiquni të jeni të durueshëm. Përgatituni që herët, ngase i gjithë procesi i integrit është i gjatë dhe mund të përfshijë gjithashtu pengesa të ndryshme. Mos lejoni që kjo t'ju dekurajojë.

Në qendrën tuaj të regjistrimit fillestar ju mund të ndihmoni që njerëzit e kombësive dhe kulturave të ndryshme të mund të jetojnë së bashku me sukses. Edhe nëse nuk është gjithmonë aq e lehtë, përvoja tregon: Shumë probleme mund të zgjidhen së bashku me respekt dhe konsideratë reciproke. Shpresojmë që kjo Info-Guidë t'u përgjigjet pyetjeve të rëndësishme dhe t'ju sjellë në kontakt me njerëz që mund t'ju ndihmojnë për orientim të mëtejshëm.

Ju urojmë gjithë të mirat në rrugën dhe të ardhmen tuaj.

1 Regjistrimi fillestar në Saksoni-Anhalt. Rregullorja - Furnizimi - Ofertat

Ablauf der Erstaufnahme

Nëse keni ardhur në Gjermani si person që kërkon mbrojtje dhe dëshironi të aplikoni për azil, autoritetet do t'ju caktojnë në një shtet të caktuar federal në bazë të një sistemi kuotash në një qendër të regjistrimit fillestar për azilkerkuesit. Në shtetin Saksoni-Anhalt, pritja fillestare kryhet nga Pika Qendrore e Kontaktit për Azilkerkuesit (ZAST) me seli në Halberstadt. ZAST ka filiale dhe degë.

Pranimi (regjistrimi) juaj fillestar si person që kërkon azil bëhet në ZAST. Të dhënat personale regjistrohen këtu, ju do të fotografoheni dhe do të ju merren gjithashtu edhe shenjat e gishtave.

Nëse kërkesat për azil nga vendi juaj i origjinës nuk mund të trajtohen në Saksoni-Anhalt, punonjësit do t'ju përcjellin në shtetin federal përgjegjës në mënyrë që ju të mund të dorëzoni kërkesën tuaj për azil atje.

ZAST është pjesë e qendrës së mbërritjes në Halberstadt. Ju do të merrni një ekzaminim mjekësor fillestar, strehim, ushqim, dhe gjëra të tjera të nevojshme për jetë. Ju jeni duke qëndruar këtu ose në vende të tjera të ZAST, derisa t'ju caktohet një komunë dhe ju të mund të shkoni në transferim.

Nëse ju nuk dërgoheni në një shtet tjetër federal, ju do të kaloni nëpër të gjitha fazat e procesit tuaj të azilit, gjatë kohës derisa ju jeni duke qëndruar në ZAST. Dega e Zyrës Federale për Migracionin dhe Refugjatët (BAMF) ndodhet gjithashtu në qytetin Halberstadt. Ju e dorëzoni kërkesën tuaj për azil në BAMF.




4

Ju duhet të qëndroni aty

Për kohën e regjistrimit tuaj fillestar, vlen një detyrim qëndrimi dhe banimi (shpesh i quajtur detyrimi i qëndrimit). Kjo do të thotë, që juve ju lejohet të qëndroni vetëm në një zonë të caktuar (distrikt ose rreth urban). Detyrimi i qëndrimit ekziston me qëllimin që autoritetet të mund t'ju kontaktojnë në çdo kohë që ju të mund të merrni dokumente të rëndësishme në kohë. Detyrimi është i vlefshëm për të paktën tre muaj ose për aq kohë sa jeni të detyruar të qëndroni në qendrën e regjistrimit fillestar.

Për shembull, nëse dëshironi të largoheni nga vendi i regjistrimit fillestar për të vizituar të afërmit apo për arsye të tjera, juve ju duhet një leje (leje largimi).

Për këtë dokument ju duhet të aplikoni në BAMF. Pasi ta keni marrë lejen tuaj, informoni punonjësin social të ZAST, i cili është përgjegjës për zonën tuaj, lidhur me mungesën tuaj! Nëse largoheni nga zona pa leje, ekziston rreziku i gjobës, ndërsa në rast të përsëritjes, procedimi penal.



Kohëzgjatja e qëndrimit

Sipas ligjit, kohëzgjatja e qëndrimit në ambientet fillestare të pritjes është përgjithësisht deri në 18 muaj, për familjet me fëmijë të mitur maksimumi 6 muaj. Kohëzgjatja aktuale varet nga vendimi për kërkesën tuaj për azil dhe pjesëmarrja juaj në procedurën e azilit.

Nëse vini nga vende të sigurta të origjinës si vendet anëtare të Bashkimit Evropian, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Gana, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Senegali ose Serbia, atëherë ka pak mundësi që aplikimi juaj për azil të njihet. Nëse BAMF nuk ju ofron mbrojtje, ju jeni të detyruar të jetoni në qendrën për regjistrimin fillestare derisa të largoheni nga vendi. Për familjet me fëmijë të mitur vlen edhe në këtë rast kohëzgjatja maksimale prej 6 muajsh.

5

Banimi

Ju do të akomodoheni në objekte të ndryshme akomoduese të ZASSt në varësi të nevojave dhe mundësive. Ju lutemi për mirëkuptim që ju nuk keni të drejtë për një strehim individual. Në të shumtën e rasteve akomodimi është në dhoma të përbashkëta. Nëse keni ndonjë pyetje ose problem, ju lutemi kontaktoni punonjës social përgjegjës për zonën tuaj.

Mbrojtja e veçantë për gratë


Gratë që udhëtojnë vetëm ose gratë me fëmijët e tyre do të akomodohen në një zonë të veçantë. Këshillat shoqëruese në këtë fushë ofrohen nga punonjësit socialë. Gjatë konsultimit ju mund të adresoni hapur problemet tuaja specifike. Punonjësit socialë do të angazhohen në çështjen tuaj dhe ju mbështesin me të gjitha pyetjet dhe problemet.

Identiteti seksual

Në Gjermani askush nuk guxon të diskriminohet për shkak të orientimit seksual (njerëz lezbike, gej, biseksualë, transgjjinorë, transeksualë, interseksualë dhe queer). Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me këtë dhe/ose kërkoni kontakte me qendrat e këshillimit, ju lutemi kontaktoni punonjës social. Vini re shenjat lajmëruese (ylberi) për oferta të veçanta këshillimi.

Mbrojtja e të miturve të pashoqëruar

Nëse jeni më i ri se 18 vjeç (i mitur) dhe jeni në Gjermani pa një përkujdesës ose kujdestar ligjor, atëherë keni veçanërisht nevojë për mbrojtje. Pas mbërritjes suaj do të pranoheni menjëherë nga zyra përgjegjëse e mirëqenies së të rinjve. Pra, ju nuk do të qëndroni në qendrën e regjistrimit fillestar, por do të këshilloheni, kujdeseni dhe akomodoheni nga shërbimi i mirëqenies së të rinjve.



Shpërndarja (Transferi) në Komuna

Nëse kërkesa juaj për azil është miratuar, ju do të përcaktoheni në një komunë. Stafii i ZASSt do t'ju tregojë se cila komunë do t'ju pranojë. Kërkesat personale në lidhje me qëndrimin në Saksoni-Anhalt nuk mund të merren parasysh. Megjithatë, nëse keni familjarë të shkallës së parë (fëmijë, prindër dhe në raste të miturve vëllezër e motra mbi 18 vjeç), ju keni mundësinë të përcaktoheni në vendndodhjen e anëtarëve të familjes.

Veprimi në rast konflikti

Kur jetoni së bashku në një hapësirë të kufizuar, mund të lindin konflikte. Në këto raste ju mund të kontribuoni në qetësimin e situatës duke vepruar me përgjegjësi.

- Ju lutemi të ruani qetësinë sa më shumë të jetë e mundur në rast konflikti.
- Përpiquni të zgjidhni mosmarrëveshjet me të përfshirët në vend duke adresuar zgjidhjet e konflikteve.
- Raportoni menjëherë te punonjësit socialë për situatat e rrezikshme.
- Në rast urgjence, njoftoni shërbimin e sigurisë.
- Nëse jeni bërë viktimë e dhunës raciste dhe e krahut të djathtë ose dhunës ndaj grave, mund t'i drejtoheni **shërbimit mobil të këshillimit të viktimave** për mbështetje dhe udhëzim.

Ku mund të ankojmë nëse ka probleme?

Qëndrimi juaj në ZASSt shërben kryesisht për të siguruar akomodim të rregullt gjatë procedurës së azilit. Nëse keni probleme me banorët e tjerë, punonjësit e objektit ose organizatat dhe autoritetet e tjera, ju lutemi kontaktoni punonjës socialë në vend me besim të plotë. Stafii i ZASSt do t'ju informojë për mundësitë për të bërë një ankesë. Aty pranohen edhe sugjerime për përmirësimin e bashkëjetesës në objekt. BAMF është i vetmi institucion përgjegjës për pyetjet në lidhje me procedurën tuaj të azilit.

Nëse keni ndonjë ankesë, mund të kontaktoni personalisht me stafin e ZASSt në çdo kohë. Për kritika ose këshilla, mund të përdorni edhe kutinë postare të ankesave të ZASSt në hyrjen e Shtëpisë A 2. Mos harroni të përfshini emrin dhe numrin tuaj të regjistrimit në mënyrë që përgjegjësit të mund t'ju përgjigjen.

Ju gjithashtu mund të dërgoni ankesën tuaj me email: complaint.box@lae.sachsen-anhalt.de. Një ankesë anonime është gjithashtu e mundur; ankesa juaj do të hetohet në çdo rast. Një ankesë nuk ka ndikim në procedurën në vazhdim të azilit.

Përkujdesja në qendrën fillestare



Shërbimet

Në ZAst do të merrni ndihma dhe pajisje fillestare të përcaktuara me ligj. Si **shërbime në formë kontributi**, ju do të merrni:

- Mëngjesin, drekën dhe darkën
- Pajisjet e shtratit dhe enët

Ju gjithashtu do të merrni **para xhepi** nga autoriteti i përfitimeve (zyra e mirëqenies sociale) për nevojat tuaja personale. Kjo paguhet me para në dorë dhe llogaritet për një person të rritur. Në rastin e familjeve, vetëm një person merr shumën e plotë, anëtarët e tjerë të familjes marrin shumën e reduktuar. Për roba, ju do të merrni kupona nga zyra e mirëqenies sociale, të cilat mund t'i përdorni për të blerë në qytet. Një furnizim i parë, i nevojshëm urgjent me veshje ofrohet në garderobën e ambienteve të akomodimit.

Puna sociale

Në të gjitha zonat e akomodimit ka punonjës socialë përgjegjës. Këtu ju mund të adresoni problemet. Këta punonjës ju ofrojnë të gjitha informacionet e rëndësishme rreth qëndrimit tuaj në objekt. Ata ofrojnë informacion në lidhje me proceset, datat dhe zhvillimet aktuale, shpërndajnë postën, ju mbështesin në pyetjet rreth aplikacioneve zyrtare dhe janë personi juaj kryesor i kontaktit në ZAst. Informohuni rreth shërbimeve tjera këshillimore dhe vini re njoftimet aktuale. Ju lutemi na tregoni nëse dëshironi të largoheni nga objekti për një periudhë më të gjatë kohore.



Përkujdesja mjekësore

Në rast të një sëmundjeje akute, shkoni në pikën e furnizimit mjekësor (**MediCare**). Këtu do të gjeni gjithmonë profesionistë mjekësorë gjatë ditëve të javës. Përveç kësaj, një ekip i ndihmës mjekësore me një autoambulancë është gjithmonë në vend në mbrëmje dhe në fundjavë.

Nëse trajtimi nga personeli mjekësor në vend nuk është i mundur, atëherë stafi i MediCare do të iniciojë trajtimin e mëtejshëm nga një specialist. Ju mund të aplikoni për certifikatën e nevojshme të trajtimit nëpërmjet MediCare në zyrën e mirëqenies sociale. Ofrohen vetëm shërbimet e nevojshme mjekësore sipas AsylbLG (Asylbewerberleistungsgesetz - Ligji mbi përfitimet e azilkërkuësve). Ju lutemi paraqisni kartën tuaj të identitetit si rezident sa herë që vizitoni MediCare. Gjithashtu, sillni me vete për vizitën e parë çdo ilaç që keni ose ju është përshkruar, ose informacion në lidhje me historinë tuaj mjekësore.



Në rast urgjence, kontaktoni me stafin në vend, kërkoni mbështetje nga banorët e tjerë dhe telefononi ndihmë profesionale përmes shërbimit të sigurisë!

Nëse disa përvoja ju dëshpërojnë shumë, nëse flini keq ose trupi juaj reagon në një mënyrë të pazakontë, ju mund të keni një traumë. Në zyrat e punonjësve social do të merrni pyetësorë për problemet tuaja, të cilët mund t'ju ndihmojnë për t'ju ofruar një ofertë të përshtatshme këshillimi. Ju lutemi flisni me punonjësit socialë ose me ekipin e MediCare. Punonjësit ju vënë në kontakt me **shërbimin tonë psikologjik**.

Nëse tashmë keni dokumente për sëmundje dhe/ose trajtime të mëparshme, sillni ato me vete në konsultën tuaj fillestare. Nëse trajtimi psikoterapeutik është i nevojshëm, shërbimi psikologjik do të ju regjistrojë në qendrat psikosociale të shtetit në qytetet Magdeburg dhe Halle (Saale).

Nëse keni nevojë për ndihmë për shkak të **HIV-it** (ose për shkak të sëmundjeve të tjera seksuale të transmetueshme), ju lutemi kontaktoni **Aids-Hilfen** në Halberstadt, Halle (Saale) ose Magdeburg. Ata do t'ju këshillojnë në mënyrë anonime dhe do t'ju japin detaje specifike të kontaktit.

Ofertat në qendrën fillestare

Organizimi i kohës së lirë

Jepini vetes kohë dhe pushim të mjaftueshëm për procedurën tuaj të azilit. Përdorni qendrat lokale të këshillimit me ofertat e tyre dhe materialet përkatese të informacionit (fletushka, video, etj.). Kjo është një mënyrë e shkëlqyer për t'u përgatitur për intervistën tuaj.

Kaloni gjithashtu kohë për të mësuar gjermanisht. Në objektin tuaj zakonisht ekziston mundësia për të mësuar gjuhën gjermane. Përdorni ofertat ekzistuese ose mësoni më shumë nga punonjësit socialë rreth mundësive për ta mësuar gjuhën në mënyrë të pavarur.

Ju lutemi vini re edhe **ofertat për orientimin fillestar, për shembull kursin e orientimit shumëgjuhësh për refugjatët.** Edhe jashtë regjistrimit fillestar (p.sh. në qendrat e arsimit për të rritur) ekziston mundësia e ndjekjes së kurseve për të mësuar gjermanisht ose për orientim të përditshëm.

Kujdes: Ju lutemi pyesni paraprakisht nëse këto kurse janë me pagesë.



Situata juaj karakterizohet nga shumë sfida dhe situata nuk është gjithmonë e lehtë edhe për fëmijët tuaj. Ofroni fëmijëve tuaj mundësi të luajnë së bashku. Në ZAST ka oferta për aktivitetet e kohës së lirë të fëmijëve tuaj, p.sh. një punëtori mësimore (Caritas). Inkurajoni fëmijët tuaj të marrin pjesë aty!

Ju lutemi vini re: Si kujdestar ligjor, ju jeni thelbësisht përgjegjës për mirëqenien dhe veprimet e fëmijëve tuaj. Kjo do të thotë që ju duhet të dini gjithmonë se ku ndodhet fëmija juaj në qendrën e banimit. Kujdesuni vetë për ta sa më shumë të jetë e mundur ose informoni kujdestarët e tjerë ligjorë se ku mund t'ju kontaktojnë. Fëmija juaj gjithashtu duhet të dijë gjithmonë se ku jeni.

Merrni pjesë në **mundësitë e punës** ose në **shërbimin e komunitetit** (përkthim, ndihmë në organizim të ngjarjeve, punë pastrimi, riparime dhe të tjera). Në këtë mënyrë ju mund të kontribuoni në përmirësimin e mjedisit tuaj të jetesës dhe të shtoni paratë tuaja të xhepit.

Përfshihuni, bisedoni me ne, shprehni kritika konstruktive! Pyetni me punonjësin tuaj social për mundësitë e pjesëmarrjes (p.sh. komiteti i kuzhinës).

Përcaktimi i aftësive profesionale

Agjencia Federale e Punësimit tashmë ofron për të përcaktuar aftësitë tuaja profesionale në qendrën e mbërritjes. Ju do të pyeteni për kualifikimet tuaja shkollore dhe profesionale, si dhe për përvojën e punës që keni pasur. Nëse këto kërkohen për tregun e punës, mund të bëhet këshillimi i shpejtë i tregut të punës si dhe referimi në këshillimin e njohjes. Një rekomandim i bazuar në nevojat për trajnim është gjithashtu i mundur kur të caktoheni në një komunë.

Për shumicën e profesioneve kërkohen kompetenca dhe kualifikime. Në veçanti, nëse tashmë keni përfunduar një shkollim profesional ose keni një diplomë, do të duhej të shfrytëzoni mundësitë e ofruara për **përcaktimin e aftësive tuaja**.



2 Procedura e azilit

E drejta themelore për azil

E drejta për azil është një e drejtë themelore ndërkombëtare. Në Republikën Federale të Gjermanisë kjo është pjesë e Ligjit Bazë (neni 16a: "Personat e përndjekur politikisht gëzojnë të drejtën e azilit."). E drejta e azilit mund të ushtrohet nëse mund të tregohet se ju është dashur të ikni nga persekutimi politik në vendin tuaj ose nëse jeta juaj ishte në rrezik atje për arsye të tjera. Për më tepër, duke iu bashkuar Konventës së Gjenevës për Refugjatët, Gjermania është zotuar të pranojë refugjatë që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare. Si rezultat, arsyet individuale për mbrojtjen tuaj shqyrtohen në një procedurë azili.



Zyra Federale për Migracionin dhe Refugjatët (BAMF)

Në Gjermani, një kërkesë për azil mund të dorëzohet vetëm në Zyrën Federale për Migracionin dhe Refugjatët (BAMF). BAMF nuk është një gjykatë, por një institucion. Ai hulumton nëse jeni të persekutuar në vendin tuaj të origjinës dhe nëse do të përballeni me persekutim atje nëse ktheheni. Nëse keni qenë të persekutuar, ajo që ka rëndësi është, nëse keni pasur mbrojtje shtetërore në vendin tuaj të origjinës. Gjithashtu do të hulumtojë nëse mund të gjeni mbrojtje në një pjesë tjetër të vendit tuaj të origjinës. Ky ekzaminim është i mundur vetëm në bazë të kërkesës tuaj personale për azil. Paraqisni këtë kërkesë në BAMF sa më shpejt të jetë e mundur. BAMF do t'ju informojë se kur dhe ku mund të dorëzoni aplikimin.



Zyra Federale krijon një dosje për ju dhe regjistron të dhënat tuaja personale. Gjatë procesit të aplikimit, ju do të informoheni për të drejtat dhe detyrimet tuaja në procedurën e azilit. Ky informacion do t'ju jepet me shkrim në gjuhën tuaj amtare.

BAMF fton një ndërmjetës gjuhësor në një takim me vendimmarrësin tuaj personal. Është e drejta juaj të dëgjoheni në gjuhën tuaj amtare. Ju mund të sillni avokatin tuaj në takim. Nëse lajmëroni paraprakisht, ju mund të shoqëroheni edhe nga dikush tek i cili keni besim.

Çfarë kërkohet me kërkesën për azil

Kur aplikoni për azil, ju kërkoni mbrojtje në Gjermani. Së pari, BAMF do të kontrollojë nëse Gjermania është kompetente për aplikimin tuaj.

A keni

- aplikuar tanimë për azil në ndonjë shtet tjetër evropian,
- a keni pranuar tanimë azil në ndonjë shtet tjetër evropian,
- a është refuzuar kërkesa juaj për azil në një vend tjetër evropian ose
- a keni marrë një vizë Shengen nga një vend tjetër evropian në 6 muajt e fundit,

atëherë Gjermania nuk është përgjegjëse për kryerjen e procedurës suaj të azilit. Në këtë rast do të merrni një letër nga BAMF. Aty do t'ju kërkohet të udhëtoni në vendin që është përgjegjës për ju.

Dokumentet e qëndrimit

Nga stafi i ZAST ju do të merrni "dëshminë e arritjes", përveç nëse kjo tashmë ju është dhënë diku tjetër. Dëshmia e arritjes përmban informacione rreth jush dhe një foto. Regjistrimi juaj si azilkërkuar dokumentohet me lëshimin e këtyre dokumenteve. Mbi këtë bazë, BAMF ju fton të paraqisni aplikacionin tuaj personal. Sapo ju të dorëzoni kërkesën tuaj për azil në BAMF, dëshmia juaj e arritjes do të zëvendësohet me një leje qëndrimi. Këtë dokument duhet ta mbani gjithmonë me vete dhe t'ia tregoni policisë gjatë kontrollit të identitetit. Në këtë dokument është e shënuar se në cilat zona ju lejohet qëndrimi. Sapo të ketë ndodhur transferimi juaj në një komunë pranuese në Saksoni-Anhalt, ju jeni të detyruar të informoni BAMF-në për adresën tuaj të re.

Këshilla për procedurën e azilit (AVB) dhe përgatitja për seancën dëgjimore



Në qendrën e mbërritjes ka edhe qendra këshillimi për procedurën e azilit. Në Saksoni-Anhalt, në Halberstadt, ju mund të përfitonit nga këshillat për procedurën e azilit të BAMF në formën e këshillave dhe informacionit në grup, si dhe këshillave të Caritas-it në formën e këshillave individuale. Në qendrat e këshillimit mund të mësoni për të drejtat dhe detyrimet tuaja në të gjitha hapat e procedurës së azilit. Ju gjithashtu do të merrni këshilla personale për mundësinë e kthimit vullnetar dhe migrimit të mëtejshëm. Në qendrat e këshillimit keni gjithashtu mundësinë të komunikoni nevoja të veçanta, të cilat duhet të merren parasysh në seancën dëgjimore në BAMF. Këto konsultime janë falas, anonime dhe të pavarura nga besimi apo botëkuptimi juaj.

Seanca dëgjimore

Procesi i **seancës dëgjimore**, i quajtur shpesh edhe „intervista“, është mundësia më e rëndësishme për aplikantët që për herë të parë të shpjegojnë arsyet e arratisjes. Në bazë të kësaj seance, Zyra Federale për Migracionin dhe Refugjatët vendos nëse ju jepet mbrojtje në Gjermani.

! Ju lutemi vini re: Seanca është mundësia e parë dhe e vetme që ju të shpjegoni në detaje motivet tuaja personale për të kërkuar azil! Bëhuni të vetëdijshëm për rëndësinë e kësaj interviste dhe përgatituni mirë për seancën dëgjimore!

Në varësi të kapaciteteve të BAMF-së, seanca dëgjimore zhvillohet pak kohë pas dorëzimit të aplikimit. BAMF ju fton me shkrim në "seancën dëgjimore sipas Nenit 25 të AsylG». (AsylG: Asylgesetz - Ligji për Azilin) Një ndërmjetës gjuhësor është i pranishëm në këtë rast. Informoni me kohë Zyrën Federale në cilën gjuhë duhet të zhvillohet seanca, **seanca dëgjimore në gjuhën tuaj amtare**



është e drejta juaj si azilkërkuar. Kërkesat e veçanta, p.sh., një grua si ndërmjetëse gjuhësore, duhet të lajmërohen në kohë.

Për arsye të veçanta përndjekjeje (persekutim specifik gjinor, LGBTIQ* ose viktima të torturës) kemi përfaqësues të posaçëm të trajnuar në BAMF. Ju lutemi shprehni mendimin tuaj në kohën e duhur, për shembull në këshillimin për procedurën e azilit ose te punonjësi social, nëse keni nevojë për mbështetje të veçantë gjatë seancës.

Ka shumë pyetje të përfshira në seancë. Do t'ju kërkohet informacion për origjinën tuaj, arsyet e arratisjes dhe rrugën tuaj të udhëtimit. **Ndani kohë për këtë.** Bëni të gjitha informacionet të plota dhe të vërteta. **Nëse është e mundur, jepni dokumente ose foto mbështetëse.** Vendimmarrësi do të kontrollojë nëse informacioni i dhënë gjatë regjistrimit tuaj është i saktë. Ju keni të drejtë që deklaratat tuaja të përkthehen përsëri për ju. Kontrolloni të gjitha deklaratat e seancës për korrektësi në procesverbalin e përkthyer dhe më pas konfirmoni ato me nënshkrimin tuaj.

! Kujdes: Sigurohuni që të kontrolloni nëse emrat e të gjithë anëtarëve të familjes janë shkruar saktë.

Vendimi i Zyrës Federale

BAMF do t'ju informojë me shkrim (njoftim) për vendimin mbi kërkesën tuaj për azil. Vendimi është i arsyetuar dhe atij i bashkëlidhet një informacion mbi mjetet juridike. Ky udhëzim tregon nëse dhe si mund të rishikohet dhe kontestohet vendimi.

Ju do të merrni një vendim pozitiv **nëse**:

- Ju njihet e drejta për azil në përputhje me nenin 16a të kushtetutës, ose
- Ju jepet mbrojtja e refugjatit në përputhje me Nenin 3 të Ligjit për Azil, ose
- Ju jepet mbrojtja plotësuese në përputhje me Nenin 4 të Ligjit për Azil, ose
- nëse vendoset një ndalim dëbimi për vendin tuaj të origjinës në përputhje me Nenin 60 Par. 5 ose Par. 7 të Ligjit mbi qëndrimin.

Një vendim pozitiv e arsyeton një leje qëndrimi. Kjo shoqërohet me një leje qëndrimi që mund ta merrni nga autoritetet përgjegjëse të imigracionit. Në varësi të rastit, fillimisht do t'ju jepet një qëndrim me një kohëzgjatje nga një deri në tre vjet.

Nëse kërkesa refuzohet, do të merrni një **urdhër për t'u larguar** nga vendi dhe një **kërcënim për dëbim**, i cili ju detyron të largoheni nga vendi. Nëse nuk largoheni nga vendi në kohë, ju do të dëboheni dhe do të duhet të përballoni shpenzimet që rezultojnë. Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me largimin tuaj, do të merrni mbështetje nga shërbimi i këshillimit për kthim. Nëse dëbimi nuk është i mundur, Zyra për të Huajt mund të lëshojë përkohësisht një Duldung (pezullim të përkohshëm të dëbimit). Duldung është një dokument identifikimi i përkohshëm që ju identifikon si person të regjistruar. Ai nuk është një leje qëndrimi. Detyrimi për t'u larguar nga vendi mbetet.

Përfshirja e një avokati

Nëse është e nevojshme, ju mund të ndërmerrni veprime ligjore kundër vendimeve të Zyrës Federale. Aplikantët informohen për mjetet e mundshme juridike dhe afatet në informacionin mbi mjetet juridike. Ju lutemi vini re se ju duhet të reagoni shpejt nëse doni të ngrini një ankesë.

Ju gjithashtu duhet të ndërmerrni veprime që herët, në rast se dëshironi të përfshini një avokat. Këshilla të pavarura për mbrojtjen ligjore në procedurën e



azilit ofrohen në Saksoni-Anhalt nga Këshilli për procedurën e azilit të Caritas-it dhe Këshillit të refugjatëve.

Paraqisni një aplikim pasues ose aplikim konfirmues

Ju mund të paraqisni një kërkesë pasuese nëse keni marrë një vendim negativ në procedurën tuaj të parë të azilit në Gjermani. Një aplikim pasues duhet të bëhet personalisht në BAMF, e cila tashmë ka vendosur për procedurën tuaj të parë. Një procedurë e mëtejshme për azil (aplikim pasues) do të kryhet vetëm nëse situata faktike ose ligjore ka ndryshuar në favorin tuaj ose nëse disponohen prova të reja. Aplikimi pasues duhet të bëhet brenda tre muajve.

Nëse kërkesa juaj për azil është refuzuar në një vend të tretë të sigurt si Norvegjia ose Zvicra dhe Gjermania është përgjegjëse për procedurën tuaj, atëherë kjo njihet si aplikim konfirmues.

Kjo procedurë është e mundur nëse jeni personalisht i rrezikuar nga kthimi në vendin tuaj të origjinës ose nëse situata në vendin tuaj të origjinës është përkësuar. Nëse BAMF pranon dëshminë tuaj, ju do të kaloni përsëri të gjithë procedurën e azilit.

Kthimi vullnetar

Nëse jeni të detyruar të largoheni nga vendi ose nëse dëshironi të ktheheni në vendin tuaj, kthimi vullnetar ofron një alternativë me konflikt të ulët dhe të sigurt për kthimin e detyruar.

Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) promovon kthimin vullnetar me programin **REAG/GARP**, ofron grante udhëtimi, asistencë për start-up dhe ju mbështet kur të ktheheni në vendin tuaj të origjinës ose kur emigroni në një vend të tretë pritës.

Shteti i Saksonisë-Anhalt ju ofron këshillim kthimi. Në raste individuale, largimi juaj vullnetar mund të mbështetet financiarisht edhe nëpërmjet programit të vendit tuaj. Financimi i mundshëm mund të jetë: Shtesat e udhëtimit dhe shpenzimet e udhëtimit, prokurimi i zëvendësimit të pasaportës, mbështetje mjekësore, kostoja e jetesës, Shpenzimet e fillimit të biznesit e shumë të tjera.

Mësoni më shumë nga punonjësit socialë në vend, të cilët do t'ju vënë në kontakt me shërbimin e këshillimit të kthimit ose kontaktoni me Magdeburger Stadtmission e. V. në adresën e emailit rueckkehrberatung@magdeburger-stadtmission.de. Këta njerëz do t'ju mbështesin me aplikimin dhe organizimin e largimit tuaj. Nuk keni asnjë të drejtë ligjore për mbështetje financiare ose mbështetje tjetër për kthimin vullnetar.

Bashkimi i familjeve

Si refugjat i njohur ose si person me të drejtë azili, ju keni të drejtë që bashkëshorti juaj dhe fëmijët tuaj të mitur të pamartuar t'i bashkohen me lehtësi familjes. Për ta bërë këtë, paraqisni një kërkesë për bashkim familjar të privilegjuar në Zyrën Federale të Jashtme. Kjo do të thotë që familja juaj e ngushtë lejohet të hyjë në Saksoni-Anhalt së bashku me ju dhe merr një leje qëndrimi. Ju lutemi vini re se kjo kërkesë duhet të dorëzohet maksimumi 3 muaj pas njohjes suaj si refugjat ose person që ka të drejtë për azil.

Për personat që kanë të drejtën e mbrojtjes plotësuese, bashkimi familjar i bashkëshortit dhe fëmijëve të mitur të pamartuar, si dhe prindërve të fëmijëve të mitur është në diskrecionin e autoriteteve. Bashkimi familjar bëhet si pjesë e procedurës së vizës, pra aplikimi duhet të dorëzohet në misionin përkatës diplomatik jashtë vendit (ambasadë ose konsullatë e përgjithshme). Misioni diplomatik jashtë vendit dhe autoriteti përgjegjës për të huajt në Gjermani kontrollojnë nëse janë përmbushur kërkesat ligjore për bashkim familjar. Deri në 1000 anëtarë të familjes të personave që kanë të drejtën e mbrojtjes plotësuese mund të udhëtojnë në Gjermani çdo muaj, duhet të plotësohen disa kritere që justifikojnë bashkimin familjar në bazë të një emergjence humanitare. Bisedoni me stafin në qendrën e këshillimit të Caritas-it, i cili do t'ju japë informacionin fillestar dhe, në rast transferimi, adresat e qendrave të këshillimit.

